




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. <u>01-2910/13</u>
Dep. <u>02</u>	Br. Prot. <u>01-2910/13</u>
Nr. i faq. <u>02</u>	Data <u>20.09.2013</u>
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>20.09.2013</u>
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>20.09.2013</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	20/09/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Fatmir GJONBALAJ Drejtor i Prokurimit – Posta dhe Telekomit i Kosovës
CC:	z. Ejup QERIMI Drejtor – Posta dhe Telekomit i Kosovës – PTK
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin “ Krijimi i Reklamave për PTK-në”



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin “Krijimi i Reklamave për PTK-në”, me nr. të prokurimit: PTK 13 176 211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K). që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Krijimi i Reklamave për PTK-në” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit e Postës dhe Telekomit të Kosovës ka përgatitë “Njoftim Kontrate” me titullin: “Krijimi i Reklamave për PTK-në” me nr. prokurimi: PTK -13- 176- 211, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së më 21/08/2013, në Procedurë të Hapur. Në këtë “Njoftim për Kontratë” të publikuar në KRPP më datë 21/08/2013, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti teknike dhe profesionale”, pika b. kërkohet: Tenderuesi për këtë projekt duhet të emëroj një udhëheqës të ekipit i cili plotëson kushtet në vijim: Të ketë së paku shkollim në nivel të Masterit dhe Ai/Ajo duhet të ketë së paku 5 vjet përvojë në fushën e Marketingut. A.K të njëjtin kriter e ka potencuar edhe tek pika IV.2 Kriteret për Dhënie të kontratës ku si kriter tek pika 3 kërkohet Përvojë e udhëheqësit të ekipit kreativ. Pra, A.K në “Dosja e Tenderit” dhe në “Njoftim për Kontratë” ka paraqitur kritere të njëjta si tek “Kapacitet teknike dhe profesionale” ashtu edhe tek “Kriteret për Dhënie të Kontratës”.

Autoriteti Kontraktues duhet të sigurojë që në “Dosja e Tenderit” dhe në “Njoftim për Kontratë” të bëjë dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës. A.K në “Dosja e Tenderit” dhe në “Njoftim për Kontratë” i ka përcaktuar si kritere të matjes me peshë të caktuar, pika 2. Përvoja e Kompanisë dhe pika 3. Përvoja e Udhëheqësit të Ekipit Kreativ, këto kritere do të duhej të ishin të përcaktuar si kritere minimale për kualifikim.

Veprimet e A.K të cekura më lartë, bien ndesh me nenin **52.3** dhe **52.4** të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 dhe nenit **23.5** të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se një shkelje e tillë nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Me respekt!